



2
0
2
4

BULETINI

TETOR



Ritja e ndërgjegjësimit për Kancerin e Gjirit: Zbulimi i hershëm shpëton jetë

Në kuadër të Muajit Rozë, kushtuar ndërgjegjësimit për kancerin e gjirit, në Komunën e Lipjanit u organizua takim për të koordinuar aktivitetet e planifikuara dhe për të diskutuar përpjekjet e përbashkëta ndërmjet institucioneve dhe qytetarëve, me qëllim krijimin e një mjedisi mbështetës për gratë që përballen me kancerin e gjirit.

Kryetari i Komunës së Lipjanit, z. Imri Ahmeti theksoi rëndësinë e kësaj nisme dhe përkushtimin e komunës për të mbështetur gratë që përballen me këtë sëmundje.

"Ndërgjegjësimi dhe edukimi për kancerin e gjirit janë thelbësore. Bashkë me institucionet tona shëndetësore, ne jemi të përkushtuar për të siguruar që çdo grua të ketë qasje në kontrolle shëndetësore dhe mbështetje, sidomos gjatë këtij muaji ndërgjegjësues" tha kryetari Ahmeti.

Ai po ashtu ftoi qytetarët e Lipjanit të marrin pjesë në aktivitetet e Muajit Rozë, për të përhapur sa më shumë mesazhin e rëndësisë së kontrolleve të rregullta shëndetësore dhe për të ndihmuar në ndërtimin e një të ardhmeje më të shëndetshme për gratë në Lipjan dhe më gjerë.



Dita Ndërkombëtare e të Moshuarve Kryetari Ahmeti vlerëson kontributin e të moshuarve në Lipjan

Me rastin e Ditës Ndërkombëtare të të Moshuarve, Kryetari i Komunës së Lipjanit, z. Imri Ahmeti, ka pritur në një takim të veçantë përfaqësues të të moshuarve të komunës. Gjatë takimit, Kryetari Ahmeti u ka shprehur mirënjohje të thellë për kontributin e tyre të pazëvendësueshëm në zhvillimin e shoqërisë.

"Ju jeni themeli i shoqërisë sonë, kontributi dhe përvoja juaj mbeten të paçmueshme dhe ne jemi krenarë për gjithçka që keni bërë dhe vazhdoni të bëni për Lipjanin," tha z. Ahmeti. Nga ana tjetër, të moshuarit u shprehën të lumtur që po shënohet kjo ditë e rëndësishme, duke theksuar se puna dhe përpjekjet e tyre ndër vite po vlerësohen, nga institucionet komunale.

Në fund të takimit, Kryetari Ahmeti ka ndarë mirënjohje për të pranishmit, duke theksuar se përkushtimi i tyre është frymëzim për gjeneratat e reja.



Kryetari i Komunës së Lipjanit, z. Imri Ahmeti, ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me drejtorin e organizatës Islamic Relief Kosova, z. Muhamed Soliman, për mbështetjen e fermerëve me mekanizëm bujqësor.

Kjo marrëveshje ka për qëllim të rrisë kapacitetet e fermerëve përmes ofrimit të mekanizmave të avancuar bujqësorë, duke përmirësuar kështu prodhimin dhe qëndrueshmërinë ekonomike të bujqësisë në Komunën e Lipjanit.

Kryetari z. Ahmeti theksoi rëndësinë e këtij bashkëpunimi për zhvillimin e sektorit bujqësor dhe përkrahjen e fermerëve.

“Kjo marrëveshje përfaqëson një mundësi të mirë për fermerët e komunës sonë, duke u mundësuar atyre qasje në pajisje dhe teknologji moderne, që do të ndihmojnë në rritjen e prodhimit bujqësor dhe zhvillimin e mëtejshëm të ekonomisë rurale,” tha kryetari Ahmeti.

Nga ana tjetër, drejtori i organizatës Islamic Relief Kosova, z. Muhamed Soliman, theksoi se bashkëpunimi me Komunën e Lipjanit është një hap i rëndësishëm për të siguruar që fermerët të kenë mjetet dhe mbështetjen e nevojshme për të përmirësuar kapacitetin e tyre prodhues në bujqësi.



Mbahet takimi i katërt i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSBB)

Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSBB), kryesuar nga Nënkyetari i Komunës së Lipjanit, z. Diamant Bytyqi, mbajti takimin e katërt të rregullt për këtë vit, ku u diskutua gjendja e sigurisë në territorin e Komunës së Lipjanit.

Nënkyetari z. Bytyqi informoi anëtarët e KKSBB-së për zhvillimet aktuale, duke njoftuar gjithashtu për miratimin e buxhetit të Komunës, i cili u aprovuar në seancën e fundit të kuvendit.

“Në seancën e fundit të Kuvendit të Komunës së Lipjanit është miratuar buxheti në vlerë prej 24,897,038 euro, i cili pritet të kontribuojë në realizimin e projekteve të shumta zhvillimore në të gjithë komunën,” tha Nënkyetari z. Bytyqi.

Gjatë takimit, komandanti i Policisë së Kosovës për Lipjan, z. Argjend Gashi, prezantoi një raport të detajuar mbi gjendjen e sigurisë në komunë, duke përfshirë statistika për shkeljet në trafik, dhe vlerësoi se gjendja e përgjithshme e sigurisë është e qetë.

Anëtarët e KKSBB-së theksuan rëndësinë e bashkëpunimit ndër-institucional dhe bënë thirrje për angazhim më të madh të qytetarëve në bashkëpunim me policinë për përmirësimin e sigurisë në komunitet.



Tetori Rozë muaji i ndërgjegjësimit për Kancerin e Gjirit

Me moton “Kancerin e gjirit e mposhtim së bashku”, në qytetin e Lipjanit është mbajtur një marsh sensibilizues për ndërgjegjësimin rreth sëmundjes së kancerit të gjirit, por edhe për përkrahjen e personave të prekur nga kjo sëmundje.

Marshit iu bashkua edhe Kryetari i Komunës së Lipjanit, z. Imri Ahmeti, me bashkëpunëtorë, ku tha se ne e ndajmë obligim të mbështesim aktivitete të tilla sepse janë në dobi të shëndetit të qytetarëve tanë.

“Dua të theksoj se detektimi i problemeve, jo vetëm shëndetësore, por edhe në jetën e përditshme, sa më herët të detektohet një problem, aq më lehtë eliminohet,” ka thënë kryetari Imri Ahmeti, duke dhënë një mesazh që t’i kushtojmë më shumë kujdes dhe vëmendje shëndetit, mos ta nënçojmë si problematikë, por të jemi më të përgjegjshëm dhe më të kujdesshëm për të diagnostikuar sa më herët sëmundje të tilla.

Ky aktivitet është mbajtur në kuadër të aktiviteteve të organizuara nga Drejtoria e Shëndetësisë dhe Përkujdesjes Sociale dhe Zyra për Barazi Gjinore në kuadër të muajit tetor, që njihet si muaji i ndërgjegjësimit kundër kancerit të gjirit.



Mbahet ligjëratë në kuadër të muajit të ndërgjegjësimit për kancerin e gjirit

Organizuar nga Drejtoria e Shëndetësisë dhe Përkujdesjes Sociale, në sallën e Kuvendit të Komunës së Lipjanit është mbajtur ligjëratë ndërgjegjësuëse, në kuadër të muajit rozë, muajit të ndërgjegjësimit për kancerin e gjirit.

Të pranishëm ishin përfaqësues nga institucionet komunale, përfaqësues nga shoqëria civile, organizata të ndryshme dhe gra të tjera.

Drejtori i Shëndetësisë dhe i Përkujdesjes Sociale, z. Shkelzen Hajdini, ka përshëndetur të pranishmit dhe ka i ka informuar se në këtë vit Komuna e Lipjanit ka siguruar një Memograf digjital në Qendren Kryesore e Mjekësisë Familjare (QKMF) “Dr. Mehdi Zejnullahu”, i cili siguron rezultate të standarteve të larta. Ai po ashtu ka inkurajuar të gjitha gratë mbi 40 vjeçare të bëjnë kontrollat të rregullta dhe të kujdesen për shëndetin e tyre.

Ndërsa, ligjeratën lidhur me këtë sëmundje e kanë zhvilluar dr. Mirjeta Cakolli Bajajncin dhe dr. Gazmend Qerkini, ku para të pranishmëve kanë ndarë informacione ndërgjegjësimi dhe mbështetjen për zbulimin e hershëm, trajnimin dhe kujdesin ndaj saj.



Manifestimi “Gjurmët e Gjeçovit 2024”

Në qytezën e Janjevës, organizuar nga Komuna e Lipjanit, përkatësisht Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, është mbajtur orë letrare kushtuar Gjurmëve të Shtjefën Gjeçovit. Nënkryetari i Komunës së Lipjanit, z. Diamant Bytyqi, theksoi se kontributi i Shtjefën Gjeçovit vjen përmes veprës “Kanuni i Lekë Dukagjinit”, të cilën ai e kodifikoi duke mbledhur të drejtën zakonore shqiptare.

“Shtjefën Gjeçovi mbetet një nga personalitetet më të rëndësishme të kulturës dhe historisë shqiptare, përmes studimeve të tij në etnografi, drejtësi, histori dhe gjuhësi, ai ka lënë një trashëgimi të pasur intelektuale për brezat që vijnë, me veprën e tij të njohur ‘Kanuni i Lekë Dukagjinit’, ai kodifikoi të drejtën zakonore shqiptare, duke luajtur një rol kyç në ruajtjen dhe dokumentimin e identitetit kombëtar,” tha nënkryetari Bytyqi.

Gjatë këtij organizimi, të pranishëm ishin edhe përfaqësuesit e Lidhjes së Shkrimtarëve të Kosovës, z. Prend Buzhala dhe z. Abdulla Troshupa, të cilët falënderuan Komunën e Lipjanit për këtë organizim të veçantë në nderim të veprës së Shtjefën Gjeçovit, njëherësh ata njoftuan se do të përgatisin një kumtesë për “Gjurmët e Gjeçovit”.

Organizimi i Gjurmëve të Gjeçovit është një nderim për kontributin e tij të pashoq dhe një përpjekje për të mbajtur gjallë vlerat e tij në memorien e të gjithë qytetarëve tanë.




Në sallën e Kuvendit Komunal, në kuadër të projektit “Fuqizimi i Komuniteteve Rurale përmes Zhvillimit të Bujqësisë”, Kryetari i Komunës së Lipjanit, z. Imri Ahmeti, së bashku me përfaqësuesit e Iniciativës për Zhvillimin e Bujqësisë IADK, kanë nënshkruar kontrata me përfituesit nga komunitetet jo shumicë.

Me këtë rast, Kryetari z. Ahmeti theksoi rëndësinë e këtij projekti për fuqizimin ekonomik të komuniteteve rurale, duke theksuar se ky bashkëpunim është një hap i rëndësishëm në rritjen e potencialit bujqësor, andaj mirëpresim bashkëpunime të tilla.

Ky projekt synon fuqizimin e bujqësisë në komunitetet jo shumicë që jetojnë në Komunën e Lipjanit, duke i mbështetur ato me pajisje të reja dhe moderne bujqësore, që do të rrisin produktivitetin dhe qëndrueshmërinë e tyre..

Ky bashkëpunim është pjesë e projektit "Fuqizimi i Komuniteteve Rurale përmes Zhvillimit të Bujqësisë", i financuar nga Agjencia Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar (Sida) dhe i përfaqësuar nga Ambasada Suedeze në Kosovë. Fondet e projektit menaxhohen nga Këshilli Danez për Refugjatët, ndërsa zbatimi i tij do të realizohet nga Iniciativa për Zhvillimin e Bujqësisë së Kosovës (IADK).



Nënkryetari i Komunës së Lipjanit z. Diamant Bytyqi, ka pritur në takim Drejtorin Ekzekutiv të Institutit të Krimeve të Kryera gjatë Luftës në Kosovë, z. At dhe Hetemi, ku me këtë rast u nënshkrua protokollin për pranimit-dorëzimit të materialeve që evidentojnë dëmet ekonomike dhe krimet e kryera gjatë luftës në Kosovë, posaçërisht në Komunën e Lipjanit.

Komuna e Lipjanit posedon një numër të konsiderueshëm materialesh, të cilat, në ditët në vijim, do t'i dorëzohen Institutit.

Ftojme të gjithë qytetarët që posedojnë materiale apo dëshmi të ngjashme t'i dorëzojnë ato, qoftë në Komunën e Lipjanit apo direkt në Institut, me qëllim të sqarimit dhe dokumentimit të së vërtetës për krimet e kryera gjatë luftës në Kosovë.



Në SH.F.M.U “Vëllezërit Frashëri” u shënua Dita Botërore e Shëndetit Mendor, me qëllim të ndërgjegjësimit për rëndësinë e kujdesit ndaj mirëqenies mendore të rinjtë.

Nënkrjetari i Komunës së Lipjanit, z. Diamant Bytyqi, theksoi se shëndeti mendor është një komponent thelbësor i mirëqenies së përgjithshme.

“Përmes aktiviteteve të tilla, ne po u japim të rinjve mundësinë që të jenë më të kujdesshëm për shëndetin e tyre emocional, duke krijuar një mjedis ku ata mund të flasin hapur dhe të kërkojnë mbështetje kur është e nevojshme”, tha Nënkrjetari Bytyqi.

Ndërsa drejtori i shkollës “Vëllezërit Frashëri”, z. Jakup Bahtiri, ka falënderuar Komunën e Lipjanit për mbështetjen në realizimin e këtij aktiviteti, i cili shënon një hap të rëndësishëm drejt edukimit të nxënësve për rëndësinë e shëndetit mendor.

Nga një mesazh për rëndësinë e shëndetit mendor patën edhe drejtori i Arsimit, z. Rasim Hasani, dhe zëdhënësja, znj. Hyra Bytyqi.

Ky aktivitet u mbështet nga Komuna e Lipjanit dhe përfshiu diskutime dhe aktivitete edukative, duke promovuar një qasje të kujdesshme ndaj shëndetit emocional dhe mendor.



Komuna e Lipjanit në bashkëpunim me OSBE-në, ka organizuar një sesion informues për gratë dhe komunitetet jo-shumicë mbi mundësitë komunale për financim, trajnim dhe qasje në punësim.

Gjatë këtij sesiioni u diskutuan mundësitë që ofron komuna për financim, trajnim dhe qasje në punësim, duke synuar përmirësimin e kushteve për zhvillimin ekonomik dhe përfshirjen më të madhe të këtyre grupeve në tregun e punës dhe në sektorin e bizneseve lokale.



Drejtoria për Arsim në Komunën e Lipjanit, në sallën e Kuvendit të Komunës ka mbajtur debat të hapur publik me qytetarë për të diskutuar Rregulloren për organizimin e punës së institucioneve edukative-arsimore të Komunës së Lipjanit.

Drejtori për Arsim z.Rasim Hasani, tha se për Komunën e Lipjanit është e rëndësishme të ketë një rregullativë ligjore për organizimin e punës së institucioneve edukative-arsimore të Komunës së Lipjanit dhe të jetë një dokument sa ma i kompletuar dhe gjithëpërfshirës. Ai ka kërkuar nga të pranishmit të jenë sa më aktivë gjatë fazës së konsultimit publik dhe të kontribuojnë me ide dhe rekomandime që kanë për synim avancimin e mëtejshëm të dokumentit.

Gjatë këtij takimi u dhanë propozime konkrete nga pjesëmarrësit lidhur me këtë dokument.



Nxënësit dhe mësime të shkollës fillore "Migjeni" në Rufc të Ri, përveçse festuan ditën e shkollës, i'u gëzuan edhe përfundimit të punimeve në renovimin e tërësishëm eficient të objektit shkollor.

Nënkryetari i Komunës së Lipjanit, z. Diamant Bytyqi, ka uruar nxënësit dhe mësime të shkollës me rastin e ditës së shkollës dhe njëkohësisht ka theksuar se Komuna e Lipjanit është duke investuar vazhdimisht në renovimin e objekteve shkollore, me qëllim që të sigurojmë një të ardhme më të mirë për brezat e rinj.

Ndërsa, Drejtori i Arsimit, z. Rasim Hasani, ka theksuar rëndësinë e investimeve të vazhdueshme në infrastrukturën e këtij objekti shkollor, me qëllim të përmirësimit të kushteve dhe për zhvillimin e një arsimit më cilësor.

Drejtori i shkollës, z. Metush Jashanica, falënderoi Kryetarin e Komunës, z. Imri Ahmeti, për përkushtimin dhe investimet e vazhdueshme në përmirësimin e kushteve për zhvillimin e procesit mësimor.



Drejtori i Arsimit në Komunën e Lipjanit z. Rasim Hasani, ka nënshkruar Memorandum Mirëkuptimi me IPKO Foundation për zbatimin e programit të bursave EmpowerHER.

Ky program synon të fuqizojë vajzat nga grupet e marginalizuara, zonat rurale dhe familjet me vështirësi financiare, duke u ofruar mundësi për zhvillimin e aftësive në fushën e teknologjisë.

Memorandumi ka për qëllim forcimin e bashkëpunimit të suksesshëm ndër vite midis Komunës së Lipjanit dhe IPKO Foundation, duke hapur një kapitull të ri për të rinjtë e Komunës së Lipjanit në edukimin joformal dhe teknologjik.



Nënkryetari i Komunës së Lipjanit, z. Diamant Bytyqi, së bashku me nënkryetarin për komunitetet, z. Lulzim Qerimi, dhe përfaqësuesit e Komitetit për Komunitete, pritën sot në takim Komisionin për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.

Qëllimi i këtij takimi ishte të vizitoheshin nga afër komunat që shërbejnë si modele për bashkëjetesën e komuniteteve dhe, njëkohësisht, të diskutoheshin sfidat me të cilat përballen komunitetet e këtyre komunave.

Nga Komisioni të pranishëm ishin z. Hydajet Hyseni, z. Enis Kervan, znj. Arjeta Rexhepi dhe z. Bekim Arifi. Gjatë takimit, u vlerësua Lipjani si një komunë model për bashkëjetesën e komuniteteve, duke theksuar harmoninë dhe bashkëpunimin ndërmjet tyre.

Pas takimit, përfaqësuesit e Komunës së Lipjanit, së bashku me anëtarët e Komisionit, vizituan Janjevën për të parë nga afër bashkëjetesën e komuniteteve të ndryshme në këtë lokalitet.



Nënkryetari i Komunës së Lipjanit, z. Diamant Bytyqi, së bashku me Grupin Punues të Performancës Komunale, kanë pritur në një takim pune përfaqësueset e projektit DEMOS dhe konsulentët vendorë të angazhuar nga ky projekt.

Nënkryetari Bytyqi ka falënderuar projektin DEMOS për bashkëpunimin e vazhdueshëm me Komunën e Lipjanit, si dhe ka vlerësuar punën e Grupit të Performancës Komunale, të cilët gjatë gjithë këtyre viteve kanë sjellë rezultate të larta për komunën tonë dhe kanë krijuar një databazë të qëndrueshme të të dhënave.

Gjatë këtij takimi janë diskutuar fushat dhe indikatorët që janë pjesë e Sistemit të Menaxhimit të Performancës Komunale (SMPK) dhe saktësia e raportimit të të dhënave që ka ofruar Komuna e Lipjanit duke u bazuar në udhëzuesit dhe dokumentin kryesor të SMPK-së. Po ashtu, nga anëtarët e Grupit të Performancës Komunale janë ndarë përvojat e tyre gjatë grumbullimit të materialeve dhe fazës raportuese.

Nga përfaqësuesit e projektit DEMOS u theksua se Komuna e Lipjanit është shembull në nivel vendi për ofrimin e materialeve dhe dokumentimin e secilit indikator, duke u bërë kështu komunë model për raportim korrekt në SMPK.



Nënkryetari i Komunës së Lipjanit z. Diamant Bytyqi me bashkëpunëtorë, ka pritur në takim zv. Komandantin e KFOR-it në Kosovë Gjeneral Federico Bernaccai shoqëruar nga pasardhësi i tij i cili së shpejti do ta merr detyren Gjenerali Cahit Irican ku kanë biseduar për situatën e sigurisë dhe zhvillimet e tjera në Komunën e Lipjanit.

Fillimisht Nënkryetari Bytyqi, ka falenderuar Gjeneralin Bernaccai për kontributin e deritanishëm në misionin e tij në Kosovë dhe e uroi atë në angazhimet e tjera. Po ashtu i ka uruar mirëseardhje Gjeneralit Irican për marrjen e detyrës si zv.komandant i KFOR-it në Kosovë.

Nënkryetari Bytyqi ka vlerësuar lartë bashkëpunimin e shkëlqyeshëm ndërmjet komunës dhe KFOR-it, si dhe shprehi gatishmërinë që një bashkëpunim i tillë të vazhdojë edhe në të ardhmen me qëllim të ofrimit të një ambienti sa më të sigurt për qytetarët.



Ka filluar asfaltimi i rrugës “Kongresi i Manastirit” në Zllakuqan

Kjo rrugë e cila lidh dy fshatra atë të Zllakuqanit me Ribarin e Madh, është rreth 1 kilometër e gjatë dhe 5 metra e gjerë dhe do të lehtësojë qarkullimin e veturave në këtë zonë.

Përveç asfaltimit në kuadër të këtij projekti do të vazhdojnë punimet edhe në ndërtimin e trotuarit dhe instalimin e ndriçimit publik.



Komiteti për Komunitete ka zhvilluar punimet e mbledhjes së 31-të me radhë

Në sallën e takimeve në Komunën e Lipjanit, është mbajtur mbledhja e 31-të e Komitetit për Komunitete (KK), udhëhequr nga kryesuesi i komitetit z. Skender Bikliqi, janë shqyrtuar të gjitha pikat e rendit të ditës.

Gjatë këtij takimi drejtori i Arsimit në Lipjan z. Rasim Hasani, ka dhënë një informatë lidhur me fillimin e procesit mësimor 2024-2025.

Po ashtu përfaqësuesit nga Zyra Lokale për Komunitet kanë informuar anëtarët e Komitetit për Komunitete punët dhe aktivitetet e këtij sektori.

Në fund para mbylljes së mbledhjes anëtarët e KK-së shqyrtuan edhe disa çështje të ndryshme që kanë të bëjnë me jetën e qytetarëve të Komunës së Lipjanit.



Kryetari Ahmeti nënshkruan Memorandum Mirëkuptimi me Shoqatën e Miqësisë Kosovë-Austri

Kryetari i Komunës së Lipjanit, z. Imri Ahmeti, ka nënshkruar Memorandum Mirëkuptimi me Shoqatën e Miqësisë Kosovë-Austri, që synon shënimin e përvitshëm të Ditës së Shtetësisë së Austrisë, e cila festohet më 26 tetor.

Ky memorandum ka për qëllim të promovojë bashkëpunimin ndërmjet Komunës së Lipjanit dhe Shoqatës, duke theksuar rëndësinë e marrëdhënieve miqësore mes Kosovës dhe Austrisë dhe duke kontribuar në forcimin e tyre.



KPF zhvilloi punimet e mbledhjes së 30-të me radhë

Komiteti për Politikë dhe Financa (KPF), udhëhequr nga Kryesuesi i Kuvendit z. Daut Azemi, ka mbajtur mbledhjen e 30-të me radhë, ku janë diskutuar të gjitha pikat e rendit të ditës të parapara për këtë mbledhje. Në fillim të këtij takimi, u prezantua raporti shpenzimeve dhe i të hyrave janar-shtator 2024, për të vazhduar me diskutimin e pikave të tjera të cilat ishin të propozuara për këtë takim.

Gjatë kësaj mbledhje anëtarët e KPF-së aprovuan dhe rekomanduan të gjitha pikat për mbledhjen e ardhshme të Kuvendit të Komunës, e cila do të mbahet të enjten, më 24 tetor 2024.



Kryetari i Komunës së Lipjanit, z. Imri Ahmeti, së bashku me Nënkryetarin, z. Diamant Bytyqi dhe Drejtorin e Arsimit, z. Rasim Hasani, kanë pritur në takim përfaqësuesit e SHFMU “Rexhep Akllapi” për suksesin e arritur nga Klubi i Super Vullnetarëve “Yjet”, i cili fitoi vendin e parë në edicionin e pestë të Çmimit Rajonal të Vullnetarizmit Edukativ, të organizuar në Sllovaki.

Gjatë takimit, Kryetari Ahmeti shprehu mirënjohjen e tij për arritjen e suksesit dhe vlerësoi nxënësit dhe arsimtarët që kontribuan në këtë rezultat të rëndësishëm.

“Ky sukses është një shembull i shkëlqyer i punës së përkushtuar dhe vlerave të larta të vullnetarizmit, që reflektojnë jo vetëm krenari për Lipjanin, por edhe për gjithë Kosovën”, tha Kryetari Ahmeti.

Klubi i Super Vullnetarëve “Yjet” u shpall fitues në kategorinë e Edukimit Jo-formal për projektin e tyre inovativ “Një herë një hero, gjithë jetën hero”, projekti i zhvilluar në bashkëpunim me Kryqin e Kuq, përfshinte trajnime për ofrimin e ndihmës së parë, ku Super Vullnetarët ndanë njohuritë e tyre me mbi 200 nxënës, prindër dhe mësues në komunitetin e tyre, duke rritur kështu ndërgjegjësimin dhe përgatitjen për situata emergjente.

Kryetari Ahmeti, në shenjë mbështetjeje për suksesin e arritur nga Klubi i Super Vullnetarëve “Yjet”, ka ndarë një shpërblim prej 1000 euro për ekipin fitues.



Kryetari Ahmeti nënshkruan Memorandum Mirëkuptimi me organizatën holandeze CNVP

Kryetari i Komunës së Lipjanit, z. Imri Ahmeti, ka nënshkruar Memorandum Mirëkuptimi me përfaqësuesin e organizatës holandeze CNVP për realizimin e studimit të fizibilitetit mbi sistemin e ngrohjes në qytetin e Lipjanit.

Qëllimi i këtij memorandumi është të shyrtojë mundësitë për zbatimin e një sistemi ngrohjeje me biomasë, si dhe mundësi të tjera alternative nëpërmjet energjisë së ripërtërishme në qytetin e Lipjanit, si pjesë e projektit “Përdorimi i Qëndrueshëm i Burimeve Natyrore për Mjedis dhe Zhvillim Ekonomik” (SUNREED).

Ky projekt mbështetet nga Ambasada e Suedisë dhe Agjencia Suedeze për Zhvillim Ndërkombëtar (SIDA).



U mbajt mbledhja e 34-të me radhë e Kuvendit të Komunës së Lipjanit

Kuvendi i Komunës së Lipjanit, udhëhequr nga Kryesuesi z. Daut Azemi, ka zhvilluar punimet e mbledhjes së 34-të me radhë, në të cilën u shqyrtuan dhe u aprovuan pikat e rendit të ditës të propozuara për këtë mbledhje me një pike tjetër shtesë.

Fillimisht, këshilltarët kanë adresuar një mori pyetjesh për ekzekutivin komunal, ku edhe në të njëjtën kohë kanë marrë përgjigje nga Nënkryetari i Komunës së Lipjanit Diamant Bytyqi.



Kryetari i Komunës së Lipjanit, z. Imri Ahmeti, ka pritur në takim znj. Mehreme Goliqi dhe z. Adriatik Llugiqi, fitues të çmimit "Harmony Hero Awards" 2024, i cili ndahet nga Zyra e RYCO-s në Kosovë dhe Ambasada e Gjermanisë për promovimin e paqes dhe bashkëpunimit.

Gjatë takimit, Kryetari z. Ahmeti vlerësoi arritjet e të rinjve dhe theksoi angazhimin e tij për të mbështetur iniciativa që promovojnë harmoninë dhe zhvillimin në komunitet. Ai shprehu gjithashtu mirënjohje për mbështetjen e znj. Krenare Gashi Krasniqi, drejtuesen e Zyrës së RYCO-s.

Ky çmim synon të nderojë individët që kontribuojnë në ndërtimin e paqes dhe promovimin e bashkëpunimit ndërkomunitar.



Kryetari i Komunës së Lipjanit, z. Imri Ahmeti, ka pritur në takim Drejtorin Gjeneral të Fondacionit Maarif, z. Mehmet Nedim Aslan, me të cilin diskutuan për bashkëpunimin e vazhdueshëm ndërmjet komunës dhe Shkollës Ndërkombëtare Maarif në Lipjan.

Kryetari z. Ahmeti vlerësoi kontributin e Fondacionit Maarif dhe theksoi rëndësinë e partneritetit të ndërsjellë për zhvillimin e arsimit. Ai gjithashtu shprehu gatishmërinë e tij për të mbështetur çdo iniciativë të ardhshme që synon të forcojë bashkëpunimin dhe të krijojë mundësi më të mira arsimore për të rinjtë e Lipjanit.

Drejtori i Fondacionit Maarif, z. Aslan, falënderoi Kryetarin Ahmeti për pritjen dhe mbështetjen e vazhdueshme, duke theksuar rëndësinë e bashkëpunimit me Drejtorinë e Arsimit në Lipjan. Ndërsa si shenjë mirënjohjeje, z. Aslan i dhuroi Kryetarit një simbol të shkollës, për bashkëpunimin dhe mbështetje nga komuna e Lipjanit.



Lipjani Aero Show 2024 sjell spektakël ajror dhe argëtim për të gjithë qytetarët

Qyteti i Lipjanit u shndërrua në një arenë të vërtetë spektakli ajror, duke tërhequr dashamirës të aviacionit, gjatë kësaj dite u zhvilluan aktivitete të shumta, përfshirë prezantimin e aeroplanëve, deltaplanëve dhe teknologjive të dronëve, si dhe fluturime spektakolare mbi qytetin e Lipjanit për të pranishmit.

Kryetari i Komunës së Lipjanit, z. Imri Ahmeti, theksoi rëndësinë e kësaj ngjarjeje për promovimin e turizmit dhe sporteve ajrore në Lipjan.

“Kjo ngjarje padyshim që kontribuon në zhvillimin e turizmit dhe sporteve ajrore, prandaj mbështetja jonë për aktivitetet të tilla do të jetë e vazhdueshme, 'Lipjani Aero Show 2024' është një mundësi e shkëlqyer për të prezantuar potencialin e komunës sonë dhe për të inkurajuar zhvillimin e aktiviteteve sportive,” tha Kryetari z. Ahmeti.

Ky aktivitet u mbështet nga Komuna e Lipjanit, në bashkëpunim me Projektin për Promovimin e Punësimit në Sektorin Privat (PPSE). Projekti financohet nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim (SDC) dhe zbatohet nga Swisscontact dhe Instituti Riinvest. “Lipjani Aero Show 2024” është organizuar nga Federata Aeronautike e Kosovës dhe Klubi Aeronautik “Shqiponjat e Kastriotit”, duke u shndërruar në një nga ngjarjet më të mëdha ajrore në vend.



U organizua aktiviteti “Tetori – Muaji i Mundësive të Barabarta për të Gjithë” në kuadër të Muajit Ndërkombëtar të Ndërgjegjësimit për Personat me Aftësi të Kufizuara, me qëllim promovimin e krijimit të një mjedisi gjithëpërfshirës.

Ky muaj fokusohet në sigurimin e mundësive të barabarta për të gjithë, duke promovuar një shoqëri gjithëpërfshirëse ku secili individ ndihet i mirëpritur dhe i barabartë në çdo fushë të jetës shoqërore.




Me një marsh simbolik me moton "Kancerin e gjirit e mposhtim së bashku", të cilit iu bashkua edhe Nënkryetari i Komunës së Lipjanit, z. Diamant Bytyqi, u përmbyllën aktivitetet e organizuara në kuadër të Tetorit Rozë, muajit të ndërgjegjësimit për kancerin e gjirit.

Ky aktivitet, i organizuar nga Drejtoria e Shëndetësisë dhe Përkujdesjes Sociale, udhëhequr nga drejtori z. Shkelzen Hajdini dhe Zyra për Barazi Gjinore, kishte për qëllim të përcillte mesazhin e rëndësisë së diagnostikimit të hershëm dhe mbështetjes për të gjitha gratë që përballen me këtë sëmundje.

Në këtë aktivitet u theksua se, përkundër përfundimit të muajit Rozë, kontrollimet me mamografi në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare (QKMF) "Dr. Mehdi Zejnullahu" në Lipjan, do të vazhdojnë gjatë gjithë vitit, duke ofruar mundësi për diagnostikim të hershëm dhe parandalimin e kancerit të gjirit.

Komuna e Lipjanit - Zyra për informim



0 800 14 000 / 038 200 41 508



infokomuna.lipjan@rks-gov.net



Rr. Shqipëria nr: 28 14000 Lipjan, Kosovë